



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:970/26 Datë: 19.06.2026

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregullores (AKA) nr. 02/2025 për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 150 të mbajtur më 08.06.2026, mori:

V E N D I M

I. Akreditohen programet e studimeve të Kolegjit UBT kampusi kryesor për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2026 – 30 shtator 2029):

- *Inxhinieri Mekanike (BSc) 180 ECTS, me kuotën maksimumi 70 studentë për vit akademik.*
- *Fintech dhe Analitika e Biznesit (BSc) 180 ECTS, me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik.*
- *Fintech dhe Menaxhimi i Inovacionit (MSc) 120 ECTS, me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik.*
- *Estetikë dhe Kozmetologji (BSc) 180 ECTS, me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik.*

II. Riakreditohen programet e studimeve të Kolegjit UBT kampusi kryesor për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2026 – 30 shtator 2029):

- *Shëndeti Publik dhe Menaxhment (MSc) 120 ECTS, me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik.*
- *Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor (BSc) 180 ECTS, me kuotën maksimumi 280 studentë për vit akademik.*
- *Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor (MSc) 120 ECTS, me kuotën maksimumi 120 studentë për vit akademik.*

- *Juridik (LLB) 240 ECTS, me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik.*
- III. Riakreditohet programi i studimit të Kolegjit UBT kampusi kryesor për periudhën pesë (5) vjeçare, (1 tetor 2026 – 30 shtator 2031):
- *Psikologji (BSc) 180 ECTS, me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik.*
- IV. Numri i studentëve aplikohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- V. Obligohet Kolegji UBT që deri më datë 30.09.2026 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- VI. Obligohet Kolegji UBT të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet me vendim vetëm nga KShC.
- VII. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji UBT, brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin/riakreditimin e programit të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Inxhinieri Mekanike (BSc) 180 ECTS;</i>	Mevludin Shabani Nol Dedaj Kjani Guri
2.	<i>Fintech dhe Analitika e Biznesit (BSc) 180 ECTS;</i>	Mic Ukaj Florin Alilu Nazmi Zeqiri
3.	<i>Fintech dhe Menaxhimi i Inovacionit (MSc) 120 ECTS;</i>	Shpresim Vranovci Getoar Lubeniqi Ermira Shehu
4.	<i>Estetikë dhe Kozmetologji (BSc) 180 ECTS;</i>	Allma Kocinaj Zejnë Buja Lirim Mustafa

6.	<i>Shëndeti Publik dhe Menaxhment (MSc) 120 ECTS;</i>	Zejdush Tahiri Mirinde Bilalli Rajan Arapi
6.	<i>Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor (BSc) 180 ECTS;</i>	Zejnulla Rexhepi Hadis Abdula Kreshnik Muhaxheri Fjollë Caka
7.	<i>Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor (MSc) 120 ECTS;</i>	Elvida Pallaska Binak Beqaj
8.	<i>Juridik (LLB) 240 ECTS;</i>	Jorida Xhafaj Artan Tahiri Njomëza Zejnullahu Sevdai Morina Florent Azemi Myrvete Shala
9.	<i>Psikologji (BSc) 180 ECTS;</i>	Violeta Zefi Eglantina Kraja Bardhi Valdrin Krasniqi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin UBT.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelori dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit; Inxhinieri Mekanike (BSc) 180 ECTS vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit është organizuar më 24.04.2026.

Ekipi i ekspertëve në raportin final me rekomandimeve ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht tri (3) fusha të standardeve të akreditimit.
- Substancialisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.

2. Për programin e studimit; Fintech dhe Analitika e Biznesit (BSc) 180 ECTS vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit është organizuar më 07.05.2026.

Ekipi i ekspertëve në raportin final me rekomandimeve ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Substancialisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit.

3. Për programin e studimit; Fintech dhe Menaxhimi i Inovacionit (MSc) 120 ECTS vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 07.05.2026.

Ekipi i ekspertëve në raportin final me rekomandimeve ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Substancialisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit.

4. Për programin e studimit; Estetikë dhe Kozmetologji (BSc) 180 ECTS vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 25.05.2026.

Ekipi i ekspertëve në raportin final me rekomandimeve ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht gjashtë (6) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Substancialisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.

5. Për programin e studimit; Shëndeti Publik dhe Menaxhment (MSc) 120 ECTS vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 29.04.2026.

Ekipi i ekspertëve në raportin final me rekomandimeve ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht tri (3) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit.

6. Për programin e studimit; Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor (BSc) 180 ECTS vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 12.05.2026.

Ekipi i ekspertëve në raportin final me rekomandimeve ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit,
- Substancialisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.

7. Për programin e studimit; Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor (MSc) 120 ECTS vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 12.05.2026.

Ekipi i ekspertëve në raportin final me rekomandimeve ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit,
- Substancialisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.

8. Për programin e studimit; Juridik (LLB) 240 ECTS vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 14.05.2026.

Ekipi i ekspertëve në raportin final me rekomandimeve ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit.

9. Për programin e studimit; Psikologji (BSc) 180 ECTS vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 21.05.2026.

Ekipi i ekspertëve në raportin final me rekomandimeve ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht gjashtë (6) fusha të standardeve të akreditimit dhe
- Substancialisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 150-të, të mbajtur më datë 08.06.2026, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit UBT dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekipi i ekspertëve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit UBT;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë